



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 389/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Prishtinë, për shkak të mbulimit të posterave, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 01.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë .

Arsyetim

Me datën 30.10.2013, LVV, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën ankesë pretendon se, me datë 30.10.2013, në ora 14:00, në struktura të betonit, në sheshin Nënë Tereza, afër Ministrisë së Kulturës, aktivistët LVV-së kanë vërejtur se nga AAK-ja është ngjitur posteri në vendin që vlerësohet pronë publike, pra posteri në fjalë është i kandidatës për anëtare në kuvendin komunal Monika Salihu. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se veprimi i tillë është në kundërshtim me dispozitat e nenit 33 pika b të LZP-së, si dhe me dispozitat e nenit 3.4 të Rregullorës 11/2013 të KQZ-së. Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës ka ofruar dy fotografi si dëshmi .

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik AAK, me datën 31.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 01.11.2013 deri në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK, lidhur me ankesën Anr.389/2013, ku ka theksuar se, vendosja e posterit të Kandidatës nga radhët e e AAK-së për asamble komunale nuk është bërë nga strukturat e AAK-së, mirëpo kjo mund të jetë bërë nga individ të pa identifikuar. Për më tepër ka theksuar se, me të pranuar njoftimin për ankesë ka kontaktuar strukturat menaxhuese, më konkretisht Shtabin Zgjedhedor për Komunën e Prishtinës, për ta bërë heqjen e këtij posterit .

Në përgjigje në ankesë i ka bashkangjitur provat si në vijim :

Udhëzimin e Kryetarit të AAK-së

Fotografinë në të cilat dëshmohet veprimi i largimit të posterit të vendosur në sheshin Nënë Tereza në Prishtinë

Kërkesën drejtuar shefave të Shtabeve Zgjedhore, për respektimin e Kodit Zgjedhor

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar nga LVV pretendohet se me datë 30.10.2013, në ora 14:00, në struktura të betonit, në sheshin Nënë Tereza, afër Ministrisë së Kulturës, aktivistët LVV-së kanë vërejtur se nga AAK-ja është ngjitur posteri në vendin që vlerësohet pronë publike, pra posteri në fjalë është i kandidatës për anëtare në kuvendin komunal Monika Salihu.

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se si posterat e subjektit politik AAK nuk janë vendosur në strukturë të betonit, gjë që nuk e bënë përgjegjës subjektin politik AAK .


PZAP-i, gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë, ngase dëshmitë e ofruara nga parashtruesi i ankesës nuk janë objektive, me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, për arsye se nga fotografitë e ofruara si prova nuk janë të qarta dhe bindëse që e vërtetojnë një shkelje të veprimeve të ndaluara të parapara sipas dispozitave të LZP-së .

PZAP-i, konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante nga fotografitë e paraqitura si dëshmi bindëse, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 389/2013 më datën 01.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë Juridike:

PZAP-i nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*